



**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI  
DOKUMENTET  
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Nr. 752/5 Prot. Datë 31.05.2024



**SHOQATA PATRIOTIKE  
"ÇAMËRIA"**

Nr. 37 Prot. Datë 31.05.2024

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

E lidhur sot, më datë 31.05.2024, në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

**1. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** (në vijim **AUTORITETI**), përfaqësuar nga znj. Gentiana Sula, Kryetarja e Autoritetit,

dhe

**2. Shoqata Patriotike "Çamëria"** person juridik, i krijuar me urdhrin nr. 14/1, datë 10.01.2024 të Ministrit të Drejtësisë, me seli në Tiranë, në adresën: Rruga "Nikolla Jorga" përfaqësuar nga Kryetari i Shoqatës, **z. Liljan Idrizaj**.

Palët janë marrë vesh se, për të realizuar qëllimin e përbashkët, do të respektojnë dispozitat e kësaj marrëveshjeje të shprehura më poshtë.

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e urave të bashkëpunimit në fushën e kujtesës, për rivlerësimin e historisë dhe të ngjarjeve historike që lidhen me figurat e komunitetit çam të përndjekura nga regjimi komunist, për të kontribuar në nxjerrjen e së vërtetës dhe në njohjen e së shkuarës, nëpërmjet hapësirave e mundësive për ballafaqim me dosjet, dokumentet dhe historitë e komunizmit, në mënyrë që të edukohen brezat e rinj dhe të zhvillohet dialog i shëndetshëm shoqëror, në emër të një të ardhmeje më të mirë.

## Neni 2 Objekti

Objekti i kësaj marrëveshjeje është institucionalizimi i marrëdhënieve për bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të identifikimit, grumbullimit, administrimit dhe studimit të dokumenteve e të materialeve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit të periudhës 29 nëntor 1944 - 2 korrik 1991 lidhur me persekutimin e komunitetit çam në Shqipëri gjatë periudhës komuniste.

Bashkëpunimi në fushën studimore, kujtesën kolektive dhe ndërgjegjësimin për të shkuarën, që hedhin dritë në krimet dhe pasojat e diktaturës së proletariatit në Shqipëri dhe periudhën kur ka funksionuar ish-Sigurimi i Shtetit në komunitetin çam.

## Neni 3 Baza ligjore

Kjo Marrëveshje lidhet bazuar në Ligjin nr. 45/2015 *“Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*, i ndryshuar, Ligjin nr. 119/2014, *“Për të drejtën e Informimit”*, ligjin nr. 9380 dt. 28.04.2005 *“Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”*, ligjin nr. 9154/2003, *“Për arkivat”*; Ligj nr.8788, datë 7.5.2001 *“Për organizatat jofitimprurëse”* VKM nr. 93, datë 27.02.2019, *“Për përcaktimin e tarifave dhe të pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”*; Rregullores *“Për Organizimi dhe Funksionimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”*, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 12.02.2024,

## Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Në përmbushje të kësaj marrëveshjeje, **Autoriteti dhe Shoqata Patriotike “ÇAMËRIA”** kanë të drejta dhe detyrime, dhe angazhohen të bashkëpunojnë në fushat e tyre të kompetencës dhe të misionëve, si më poshtë:

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit merr përsipër:

- a. Grumbullimin e të dhënave dhe dokumenteve për njohjen e veprimtarisë së organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, të formave të persekutimit dhe të formave të rezistencës kundër tyre, si dhe veprimtarinë që kanë çuar në dhunimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut në vitet e regjimit komunist për komunitetin çam në Shqipëri;
- b. Grumbullimin e të dhënave dhe dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit dhe ta bëjë të disponueshëm, kundrejt kërkesave;
- c. Bashkëpunimin me studiues, të cilët do të bëjnë studime afatgjata lidhur me figurat e komunitetit çam të përndjekura dhe të dënuara gjatë regjimit komunist;
- d. Hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta me shoqatën “Çamëria”
- e. Bashkërendimin e punës për kryerjen e studimeve shkencore për rolin dhe funksionin e ish-Sigurimit të Shtetit në shtet dhe shoqëri, veçanërisht në ndikimin që ky rol ka pasur në individë dhe familjet që vijnë nga Çamëria.
- f. Ofrimin e ndihmës studiuesve, objekt të kësaj marrëveshjeje;

- g. Pjesëmarrje në takime të organizuara nga secila palë, objekt i kësaj marrëveshjeje;
- h. Mbështetjen e nismave për shënjimimin e vendeve të kujtesës, bazuar në dokumentacionin e administruar nga AIDSSH dhe partnerë në bashkëpunim;
- i. Bashkërendimi i punës për edukimin qytetar nëpërmjet garantimit të mundësive për shqyrtimin e dokumenteve të organeve të diktaturës komuniste, duke përfshirë dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit të asaj periudhe;
- j. Pasurimin e narratives së historisë '44-'91 të komunitetit çam;
- k. Angazhimin e të dyja palëve në fushën e kërkimit shkencor dhe punës studimore, si mbledhje faktesh, hulumtimin, ndërtim profilesh njerëzore, shkrime artikujsh shkencore dhe informues, fushata sensibilizuese, monitorime dhe veprimtari të tjera ndërgjegjësuese;
- l. Bashkëpunimin për krijimin e materialeve digjitale, dëshmi, video, filma dokumentarë etj., të cilat pasurojnë burimet për rishqyrtimin e historisë dhe rimensionimin e ngjarjeve dhe figurave historike;

## **Neni 5**

### **Të drejtat e shfrytëzimit dhe pronësia intelektuale**

1. Të gjitha pronat intelektuale (intervista, dokumentacion arkivor, dëshmi, filma, etj.) të zotëruara nga secila Palë para nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje do të mbeten pronë e vetme e Palës, e cila i ka në pronësi.
2. Palët i japin leje jo-ekskluzive, të revokueshme, pa pagesë, njëri-tjetrit, për të përdorur materialet në pronësi të secilit, në mbështetje të këtij bashkëpunimi dhe planeve vjetore të shkëmbyera reciprokisht për periudhën e kohës gjatë së cilës zgjat marrëveshja.

## **Neni 6**

### **Kufizimet/Garancia**

1. Palët nënkuptojnë se, asnjë ndërhyrje në aktivitetet e secilës Palë nuk do të nënkuptohet si rezultat i këtij bashkëpunimi.
2. Të dyja palët nënkuptojnë se, ato nuk mund të përdorin imazhe ose përshkrime të dëshmimeve, intervistave, filmave, etj., në kuadër të projekteve të përbashkëta, për reklamim, as nuk mund t'i referohen Palës tjetër, ose këtij bashkëpunimi, në mënyrën që imponon miratimin ose sanksionimin nga ana e Palës tjetër ose të aktiviteve të tyre.
3. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit bie dakord që vulat, markat tregtare, logot, shenjat e shërbimit, emrat tregtarë, të cilët mund të jenë të pranishëm në faqen e internetit të Autoritetit, nuk do të keqpërdoren nga Autoriteti, në mënyrë të tillë që të nënkuptohet se aktivitetet e AIDSSH-së janë miratuar, sponsorizuar ose rekomanduar nga RTSH-ja, si dhe nuk do të përdoren si fakt për të qenë superiorë ndaj ndonjë produkti apo shërbimi tjetër si dhe anasjellas.

## Neni 7

### Shpërndarja e materialeve

1. Materialet e mbledhura dhe të krijuara rishtas si rezultat i bashkëpunimit, mund të publikohen dhe të transmetohen anembanë botës në platforma të shumëfishta të transmetimit, nën siglën e **shoqatës patriotike “Çamëria” dhe AUTORITETIT**, që kanë autoritetin përfundimtar redaktues për të gjitha materialet e shpërndara për transmetim apo publikim;
2. Materialet e shoqatës patriotike “Çamëria”, si dhe aplikimi përmes formularëve online të **AUTORITETIT**, mund të referohen në mënyrë të ndërsjellë nga palët, në faqet e tyre zyrtare dhe zyrat përkatëse;
3. **AUTORITETI** nuk mbanë përgjegjësi për interpretimin e materialeve që vënë në dispozicion për **shoqatës patriotike “Çamëria”** dhe në çdo rast distancohen nga gjuha e urrejtjes në trajtimin e tyre.

## Neni 8

### Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj Marrëveshjeje, **Titullarët e dy Institucioneve** do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për marrje dhe dhënie të informacionit, si dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.
3. Person kontakti nga Autoriteti: Përgjegjës, Sektori Juridik dhe Prokurimeve;
4. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format më të shpejta të komunikimit elektronik.
5. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

## Neni 9

### Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë Marrëveshje, bazuar në pëlqimin e tyre të ndërsjellë.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë, do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **AUTORITETIT** dhe **shoqatës patriotike “Çamëria”**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit.

**Neni 10**  
**Mirëbesimi**

1. **Autoriteti dhe shoqatës patriotike “Çamëria”** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim dhe të përdorin sipas fushës së veprimit të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.
3. Vështirësitë e paparashikuara, mosmarrëveshjet ose mospajtimet, që rezultojnë nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, do të zgjidhen nëpërmjet bisedave në mirëbesim, me negociata midis Palëve.

**Neni 11**  
**Afati i marrëveshjes**

1. Marrëveshja do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar, për një periudhë 4 (katër) vjeçare që nga momenti i nënshkrimit të saj, me të drejtë rinovimi dhe rishikimi. Kjo marrëveshje do të rinovohet në heshtje në përfundim të afatit të përcaktuar në këtë pikë, në rast se palët përgjatë këtij afati nuk kanë dërguar njoftim drejtuar njëra-tjetrës sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.
2. Marrëveshja mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim palës tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, palët do t’u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

**Neni 12**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera do të depozitohen në shoqatës “Çamëria”.

**Për**

**Autoritetin për Informimin mbi**

**Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**

Gentiana SULA  
  
KRYETARE  


**Për**

**Shoqatën Patriotike “Çamëria”**

Liljan Idrizaj  
  
KRYETAR  
